



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DIPLOMË

**EDHE TI MUND
TË BËHESH MAGJISTRAT!**

RAPORT MONITORIMI

Mars 2024

QENDRESA
QYTETARE



www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
DHIMITËR ZGURO

TABELA E PËRMBAJTJES

1. MESATARJA SI KRITER I PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS	3
1.1 Mesatarja si kriter ligjor	3
1.2 Rregullorja e Shkollës së Magjistraturës mbi mesataren	4
2. RISIA NË KANDIDIMIN NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS	5
3. REFLEKSIONE MBI ARGUMENTET E HEQJES SË KRITERIT TË MESATARES SË LËNDËVE KRYESORE	7
3.1 Hapja e Shkollës së Magjistraturës dhe konkurrenca më e dobishme	7
3.2 Cilësia e kandidatëve vijon të ruhet	10
3.3 Mungesa e objektivitetit në përcaktimin e kurseve të thelluara dhe të posaçme	11
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	12
BIBLIOGRAFIA	14

**EDHE TI MUND
TË BËHESH MAGJISTRAT!**

1. MESATARJA SI KRITER I PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

1.1 Mesatarja si kriter ligjor

Përpara vitit 2016, dispozitat mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ishin të shpërndara në akte të ndryshme ligjore, nënligjore dhe me natyrë rregullatore, dhe për rrjedhojë, mungonte një ligj gjithëpërfshirës që të parashikonte në mënyrë të detajuar dispozitat mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹

Me qëllim qartësimin, përmirësimin, konsolidimin dhe përmbledhjen në një ligj të vetëm, garantimin e një procesi emërimi dhe promovimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritokratike të tilla si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale, si dhe përcaktimin e qartë të procedurave që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive e transparente,² më datë 6.10.2016, në kuadër të Paketës Ligjore të Reformës në Drejtësi, u miratua ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.³ Deri më sot, ky ligj është ndryshuar pesë herë dhe disa nene janë shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017.

Kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat janë të përcaktuara në nenin 28, të ligjit ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në referim të këtij neni, çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse, ndër të tjera, ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Europian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e

¹ Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Për më shumë shih: <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Relacioni-1.pdf> aksesuar online më datë 23.02.2024.

² Po aty.

³ Ligj nr. 96/2016, datë 6.10.2016, FZ Nr. 208, datë 7.11.2016.

njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj.⁴

Më datë 23.3.2021, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 50/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".⁵ Nëpërmjet këtij ligji, ndër të tjera, do të ndryshohej dhe dispozita e sipërcituar. Kështu, sipas gërmës "c", të nenit 28, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, tashmë, çdo person që kishte përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diploma të barasvlershme, të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, do të kishte mundësinë për të kandiduar në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar. Sipas Relacionit përkatës, ky ndryshim synonte rritjen e numrit të kandidatëve, që do të konkurrojnë dhe eventualisht pas përfundimit të programit të Shkollës së Magjistraturës do të emërohen në vendet vakante.⁶

1.2 Rregullorja e Shkollës së Magjistraturës mbi mesataren

Pas miratimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli Drejtues, si organi më i lartë drejtues i Shkollës së Magjistraturës, vendosi miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, nëpërmjet vendimit nr. 1, datë 31.01.2017.

Në mbështetje të nenit 28, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Drejtues vendosi të përcaktojë në Rregulloren e Brendshme kriteret e pranimit për kandidatët që konkurrojnë për t'u pranuar në formimin fillestar. Ndër të tjera, në referim të gërmës "d", të nenit 10, të Rregullores së Brendshme, kushdo që kishte notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë), si dhe notë mesatare mbi 8 (tetë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E Drejta Civile dhe e Detyrimeve, E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme), Procedura Civile, Procedura Penale, E Drejta Administrative dhe E Drejta Kushtetuese.⁷

⁴ Po aty.

⁵ Ligj nr. 50/2021, datë 23.3.2021, FZ Nr. 71, datë 14.5.2021.

⁶ Kuvendi i Shqipërisë, Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar.". Për më shumë shih: https://kuvendivebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20210302110147Projektligji%20per%20statusin%20e%20gjyqtareve%20dhe%20prokuroreve%20ne%20Republiken%20e%20Shqipërisë-11-24_compressed.pdf aksesuar online më datë 23.02.2024.

⁷ Shkolla e Magjistraturës, Vendim nr. 1, datë 31.01.2017 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës."

Me vendimin nr. 15, datë 02.06.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1, datë 31.01.2017 'Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës'", Këshilli Drejtues vendosi të përfshijë në përlogaritjen e mesatares së lëndëve kryesore, edhe të ashtëquajturat kurse të thelluara dhe të posaçme, të lëndëve kryesore.⁸

Me qëllim lehtësimin e punës së komisionit që ngrihet për verifikimin e dokumentacionit, që përbëhet nga përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ, si dhe ruajtjen e objektivitetit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 26.01.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës", vendosi të sanksionojë se, përcaktimi i kurseve të thelluara dhe të posaçme parashikohet në Vkm Nr. 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit ofruar nga institucionet e arsimit të lartë".⁹

2. RISIA NË KANDIDIMIN NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Më datë 29.01.2024, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, në mënyrë unanime, vendosi të ndryshojë kriterin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës që lidhet me mesataren e grupit të lëndëve kryesore. Sipas vendimit nr. 1, datë 29.01.2024, të Këshillit Drejtues, kushdo që përveç kriterëve të tjera, ka mesatare të përgjithshme mbi tetë, duke mbajtur në konsideratë të gjitha lëndët e zhvilluara si në ciklin e parë, ashtu dhe në ciklin e dytë, do të mund të pranohej për të kandiduar në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar për magjistrat.¹⁰

Ky ndryshim i Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës është propozuar nën argumentat se, kriteri aktual që kërkonte njëherazi mesataren e përgjithshme mbi tetë, dhe mesataren e një grupi lëndësh mbi tetë, kishte shfaqur problematika në praktikë.

Në këtë kontekst, Shkolla e Magjistraturës, siç shprehet në Relacionin përkatës, në funksion të ofrimit të standardit më të lartë të së drejtës

⁸ Shkolla e Magjistraturës, Vendim nr. 15, datë 02.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1, datë 31.07.2017 'Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës'".

⁹ Shkolla e Magjistraturës, Vendim nr. 3, datë 26.01.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës".

¹⁰ Shkolla e Magjistraturës, Vendim nr. 1, datë 29.01.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës".

për akses në provimin e pranimit në Shkollë, sugjeroi heqjen e kriterit të mesatares së grupit të lëndëve kryesore. Përsa i takon garantimit të të drejtës për akses, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues u shpreh:

“Ne, nisur nga nevoja e hapjes së Shkollës, rritjes në procesin e kandidimit të më tepër kandidatëve sesa janë paraqitur deri më tani, për të mundësuar një konkurrencë të dobishme edhe për fituesit, kemi menduar që kriterin e mesatares së lëndëve kryesore të mos e konsiderojmë një kriter pranimi. Kjo është arsyeja e parë.”¹¹

Një tjetër shkak, sipas Shkollës së Magjistraturës, ishte dhe për shkak të mungesës së qartësisë dhe transparencës në lidhje me vlerësimin e plotësimin të kriterit të notes mesatare nga ana e kandidatëve.

Në vijim, Shkolla e Magjistraturës ka arsyetuar se:

“Përmbajtja dhe fryma e ligjeve që kanë rregulluar veprimtarinë e Shkollës ndër vite ka qenë dhe vijon të jetë ajo e epërsisë së konkurimit/provimit në Shkollë përmbi çdo kriter tjetër formal. Provimi konsiderohet matësi dhe standardi objektiv i njohurive të nevojshme që aplikanti të kualifikohet për të qenë kandidat në Shkollë.”¹²

Për rrjedhojë, sipas Shkollës, në funksion të standardit të objektivitetit në përzgjedhjen e aplikantëve, heqja e kriterit të mesatares së lëndëve kryesore nuk çënon standardin e përzgjedhjes së aplikantëve. Mungesa e objektivitetit është argumentuar, ndër të tjera, me faktin se vendimi i Këshillit të Ministrave, që rregullon rëndësinë dhe përmbajtjen e lëndëve, është i ndryshëm nga Rregullorja e Shkollës së Magjistraturës. Në këtë drejtim, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës është shprehur se:

“Vendimi i qeverisë ka përcaktuar terma të tjerë nga ato që përcakton Rregullorja jonë. Rregullorja jonë përcakton terma si, kurse të thelluara dhe të posaçme, kurse vendimi i qeverisë ku kemi bazuar këtë dispozitë të Rregullores sonë përdor termin ‘lëndë karakterizuese’. Për rrjedhojë, kjo ka bërë që identifikimi i lëndëve të tilla të jetë jo gjithmonë i njëjtë. Ky është argumenti i tretë, i cili mbështet propozimin e bërë nga ana jonë.”¹³

¹¹ Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, Relacion “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.”.

¹² Po aty.

¹³ Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, Relacion “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.”.


Për më tepër, sipas Shkollës së Magjistraturës, heqja e këtij kriteri do të rriste dhe efikasitetin e Shkollës në procesin e verifikimit të dokumentacionit dhe, rrjedhimisht, lehtësohej dhe puna e zhvilluar nga Këshillat.

Në një situatë të tillë, pavarësisht debateve dhe disa argumenteve kundër, Këshilli Drejtues, në një mbledhje me 11 anëtarë nga 19 anëtarë gjithsej, vendosi në mënyrë unanime ndryshimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës duke hequr si mesataren e lëndëve kryesore nga kriteret e pranimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistratë.¹⁴

3. REFLEKSIONE MBI ARGUMENTET E HEQJES SË KRITERIT TË MESATARES SË LËNDËVE KRYESORE

3.1 Hapja e Shkollës së Magjistraturës dhe konkurrenca më e dobishme

Një nga argumentet kryesore të përdorura në ndryshimin e kriterit të mesatares së lëndëve kryesore ishte hapja e Shkollës, rritja në procesin e kandidimit të numrit të kandidatëve, për të mundësuar një konkurrencë të dobishme. Megjithatë, ky argument, i cili ka qenë dhe argumenti kryesor në ndryshimin e kriterëve të pranimit, është mjaft i dobët dhe i papranueshëm, veçanërisht, po të mbahet në konsideratë numri i lartë i kandidatëve në raport me numrin e kuotave të pranimit në Shkollën e Magjistraturës.



Tab. 1. Numri i kuotave dhe aplikantëve që kanë kandiduar për t'u pranuar në formimin fillestar¹⁵

¹⁴ Shkolla e Magjistraturës, *Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës*, datë 29.01.2024.

¹⁵ Shkolla e Magjistraturës, *Kthim përgjigje kërkesës për informacion*, datë 05.02.2024.

Nga të dhënat e mësipërme, të vëna në dispozicion nga ana e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se që nga viti akademik 2019-2020 dhe deri më sot, numri i aplikantëve për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, është rritur vazhdimisht.


Kështu, numri i aplikantëve për t'u pranuar në formimin fillestar në vitin akademik 2017-2018 ka qenë 77, ndërkohë që numri i kuotave ka qenë 25, nga të cilat 15 kuota kanë qenë për gjyqtarë dhe 10 kuota për prokurorë. Ndërkaq në vitin 2019-2020, numri i kandidatëve ishte të paktën 3 herë më i lartë, dhe po 3 herë më i lartë ishte dhe numri i kuotave për ndjekjen e formimit fillestar.

Numri i kandidatëve qysh prej vitit akademik 2019-2020, nuk ka qenë asnjëherë më i ulët se 200, ndërkohë që maksimalisht, numri i kuotave nuk ka qenë më i madh se 100 kuota, të cilat, kanë qenë të shpërndara sipasa profileve gjyqtarë, prokurorë, apo ndihmës ligjorë.

Nëse do të mbahet në konsideratë raporti ndërmjet numrit të kuotave dhe numrit të kandidatëve, në vitin akademik 2019-2020, për një vend vakant kanë konkurruar tre kandidatë; në vitin akademik 2020-2021, për një vend vakant kanë garuar dy kandidatë; në vitin akademik 2021-2022, për një vend vakant kanë garuar tre kandidatë; kurse në vitin akademik 2022-2023, për një vend vakant kanë garuar tre kandidatë. Ndërkaq në vitin akademik 2023-2024, për një vend vakant kanë garuar katër kandidatë.

Pra nga analiza e të dhënave për të paktën pesë vitet e fundit akademike, rezulton se numri i kandidatëve nuk ka qenë asnjëherë më i ulët se 200, i cili është dhe numri më i lartë i kandidatëve që kanë aplikuar për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në dhjetë vitet e fundit akademike. Veçanërisht, numri i kandidatëve në dy vitet e fundit, ka qenë mbi 300, ç'ka tregon jo vetëm interesin aktual të profesionistëve që plotësojnë kriteret ligjore për të ndjekur formimin fillestar, por dhe ekzistencën e një konkurrence të fortë për pranimin në Shkollën e Magjistraturës.

**EDHE TI MUND
TË BËHESH MAGJISTRAT!**



Tab. 2. Numri i kandidatëve të skualifikuar¹⁶

Nga analiza e këtyre të dhënave, rezulton se, qysh nga viti akademik deri në vitin akademik 2023-2024, ka një rritje në mënyrë të vazhdueshme të numrit të kandidatëve të skualifikuar, me përjashtim të vitit akademik 2020-2021, që regjistroi numrin më të ulët të kandidatëve të skualifikuar në pesë vitet e fundit akademike.

Në vijim, rezulton se numri i kandidatëve të skualifikuar, në pesë vitet e fundit, për shkak të mosplotësimit të kriterit të mesatares së lëndëve kryesore është 49. I njëjtë rezulton të jetë dhe numri i kandidatëve që janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kriterit të mesatares së përgjithshme.

Megjithëse kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës kanë qenë të njohura për të gjithë aplikantët, siç rezulton, veçanërisht në dy vitet e fundit, numri i kandidatëve të skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kriterit të mesatares, qoftë të asaj të përgjithshme, qoftë të lëndëve kryesore, përbën pothuajse 50% të numrit të të skualifikuarve.

Këto vlera përbëjnë një indikator se, në të ardhmen, numri i aplikantëve do të rritet ndjeshëm duke i shërbyer deri-diku synimit për të rritur numrin e kandidatëve për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, megjithëse, numri i aplikantëve të vitit të kaluar përbën dhe numrin më të lartë të aplikantëve për të paktën dhjetë vitet e fundit akademike.

Megjithatë edhe sipas vetë studimeve të kryera nga Shkolla e Magjistraturës numri i studentëve kandidatë do të ishte më i lartë nga

¹⁶ Shkolla e Magjistraturës, *Kthim përgjigje kërkesës për informacion*, datë 05.02.2024.

15% deri në 20%,¹⁷ ndryshim i cili nuk është aspak domethënës, veçanërisht kur numri i studentëve është rritur me të paktën 438% nga viti akademik 2017-2018.

3.2 Cilësia e kandidatëve vijon të ruhet

Edhe sikur të pranohet se rritja e numrit të kandidatëve do të ishte më e madhe se 20%, pra do të ishte një rritje domethënëse, sërish këta të fundit nuk do të mund të ndryshonin shumë në terma të cilësisë, apo do të sillnin një model të ri, të nevojshëm, në sistemin e drejtësisë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe njëri prej anëtarëve në mbledhjen e Këshillit Drejtues, i cili ka kritikuar kohorencën në raport të vendimmarrjes, duke kërkuar që vendimet e Këshillit Drejtues të jenë në koherencë me njëra-tjetrën.¹⁸

Një tjetër anëtar i Këshillit Drejtues është shprehur me të drejtë se: “(...) nuk mund të kemi mesatare të të dikush që është shumë dobët profesionalisht, dhe e ka siguruar mesataren me lëndë të nivelit të dytë, të kategorisë lëndë me zgjedhje.”¹⁹ Megjithë këtë arsye, anëtari i Këshillit Drejtues, vijoi se, mbajtja e një kriteri të tillë është trajtimi i barabartë i të gjithë personave që trajtojnë të aplikojnë për të konkurruar në Shkollën e Magjistraturës.

Në vijim, një tjetër anëtar i Këshillit Drejtues është shprehur se:

*“Do të them edhe një argument tjetër që lidhet me lëndët kryesore. Qëllimi ka qenë që të jenë juristë të formuar dhe baza janë lëndët kryesore. Mos harrojmë që ligji ka përcaktuar edhe kufizimin që të mos vish direkt nga shkolla. Po të bësh tre vite eksperiencë. Tre vite eksperiencë dëshmojnë që këta juristë që përfundojnë një nga fakultetet e drejtësisë dhe diplomohen mund të kenë aftësi shumë të mira në ato që ne i quajmë lëndë kryesore”.*²⁰

Megjithëse në mënyrë të heshtur ka ekzistuar një konsensus përse i takon faktit se, qoftë dhe në dukje, do të ketë një cënim të cilësisë dhe cedim të Shkollës së Magjistraturës tek elementi i cilësisë së kandidatit përse i takon kriterit mesatare e lëndëve kryesore, sërish Këshilli Drejtues ka votuar pro miratimit të ndryshimit të propozuar.

Argumenti i mësipërm se, një konkurrent gjatë periudhës tre vjeçare mund të ketë përvetësuar shumë më mirë nocionet bazë ligjore, të cilat duhet të përvetësohen gjatë periudhës së studimeve universitare,

¹⁷ Shkolla e Magjistraturës, Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, datë 29.01.2024.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

është një argument i rrezikshëm. Qëllimi i kërkesës ligjore që lidhet me eksperiencën dhe përvojën tre vjeçare të kandidatit nuk lidhet vetëm me përvetësimin e njohurive, të cilat prezumohen se janë përfituar gjatë studimeve universitare, por dhe me aftësinë dhe njohuritë praktike të kandidatëve, të cilët gjatë periudhës së zhvillimit profesional, kanë zhvilluar aftësitë praktike, dhe thelluar ato teorike.

Po ashtu, anëtarët e Këshillit Drejtues, e kanë argumentuar nevojën e marrjes së një vendimi të fillë, duke theksuar se filtri për pranimin në Shkollën e Magjistraturës, por është provimi, të cilit i nënshtrohen të gjithë kandidatët, pavarësisht mesatares së tyre. Megjithëse është e vërtetë se, filtri kryesor për pranimin në Shkollën e Magjistraturës është provimi, heqja e njërit prej kritereve që ka shërbyer për filtrimin paraprak, dyshkallësh, të kandidatëve, do ta lehtësojë të gjithë procesin duke e rrezikuar potencialisht atë.

Pa dashur të paragjykojmë iniciativën e Shkollës së Magjistraturës, nisur dhe nga analiza e mësipërme, e bazuar kryesisht në të dhënat e vëna në dispozicion nga ana e Shkollës së Magjistraturës, mund të hamendësohet dhe se iniciativa e kësaj të fundit lidhet me një qëllim për të favorizuar kandidatë, të caktuar, të cilët nuk plotësojnë kriterin e mesatares së lëndëve kryesore, veçanërisht në kushtet kur numri i kuotave është ende i lartë krahasuar me pesë vitet e para, të dhjetëvjeçarit të fundit.

3.3 Mungesa e objektivitetit në përcaktimin e kurseve të thelluara dhe të posaçme

Sikundër është shprehur dhe më lart, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës është shprehur, në vija të përgjithshme se, përdorimi i nocionit “kurse të thelluara dhe kurse të posaçme” për t’ju referuar lëndëve karakterizuese sipas vendimit nr. 41, të Këshillit të Ministrave, ka krijuar konfuzion dhe cënon objektivitetin dhe transparencën në lidhje me kriteret e pranimit në formimin fillestar.

Në të njëjtën mënyrë, është argumentuar dhe nga anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues. Në këtë drejtim, disa nga argumentet e përdorura, mund të përmbliidhen si vijon: (i) vështirësia praktike për të llogaritur notën mesatare të lëndëve në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve; dhe (ii) pamundësia për të identifikuar lëndët kryesore, veçanërisht, në kushtet kur është rritur numri i universiteteve jopublike.²¹

²¹ Shkolla e Magjistraturës, *Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, datë 29.01.2024.*

Në lidhje me këtë argument, vetë Këshilli Drejtues, ka pranuar dështimin e tij për të ruajtur të njëjtën terminologji të përdorur nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë kur vjen puna tek kategorizimi dhe klasifikimi i lëndëve. Pikërisht, për shkak të këtij problem të vetë Këshillit Drejtues, i cili mund të amendohej duke përshtatur terminologjinë me legjislacionin për arsimin e lartë, u vendos heqja e kriterit të lëndëve kryesore.

Po ashtu, duke mbajtur në konsideratë vendimin nr. 41, të Këshillit të Ministrave, të vitit 2018, Këshilli Drejtues, veçanërisht në rast të njehsimit të terminologjisë, do ta kishte më të thjeshtë dhe do të arrinte të ruante objektivitetin duke përllogaritur në mesataren e lëndëve kryesore, vetëm lëndët e shprehura në mënyrë tekstuale, si dhe ato lëndë karakterizuese, të lidhura ngushtësisht me to, të cilat mund të kuptohen për shkak krediteve ECTS që mbartin si veprimtari formuese.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim, vlen të theksojmë se, vendimi i marrë nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, datë 29.01.2024, për ndryshimin e kriterëve të pranimit në formimin fillestar për magjistrat, ka synuar hapjen e Shkollës së Magjistraturës dhe mundësimin e një gare më të barabartë, e cila sipas Këshillit Drejtues, ka qenë e vështirë të garantohej për shkak të mënyrës së përcaktimit të kurseve të posaçme dhe kurseve të thelluara.

Megjithëse vendimi për ndryshimin e kriterëve të pranimit të kandidatëve për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, do të sjellë një rritje të numrit të aplikantëve, kjo rritje jo gjithmonë shkon në favor të cilësisë. Për më tepër, që veçanërisht në pesë vitet e fundit Shkolla e Magjistraturës, ka patur më shumë se 200 studentë, të cilët kandiduar për kuotat e lira për ndjekjen e formimit fillestar.

Në këtë drejtim, shqetësimet e disa prej anëtarëve të Këshillit Drejtues në lidhje me kompromisin e mundshëm në drejtim të cilësisë me qëllim rritjen e numrit të kandidatëve, mbeten serioze dhe kanë nevojë të adresohen në mënyrë efikase. Kjo nevojë lind për shkak të faktit se ndryshimi i kriterëve të pranimit mund të favorizojë, në mënyrë indirekte, kandidatët që mund të mos kenë demonstruar të njëjtin nivel aftësish në lëndët profesionale bazë, duke dobësuar, potencialisht, cilësinë e përgjithshme të magjistratëve të ardhshëm.

EDHE TI MUND
TË BËHESH MAGJISTRAT!

Në kuadër të analizës së mësipërme, vlen të theksojmë se, Shkolla e Magjistraturës, duhet të tregohet më e kujdesshme dhe më koherente në vendimmarrjet e saj, veçanërisht në ato vendime që lidhen me kriteret e pranimit në formimin fillestar. Është e vërtetë që përcaktimi i pikëve minimale që duhet të kenë kandidatët për të konkurruar në Shkollën e Magjistraturës për t'u pranuar në formimin fillestar është një kompetencë që ligjvënësi ia ka lënë vetë Shkollës së Magjistraturës, megjithatë, kjo nuk duhet të interpretohet në një mënyrë të fillë që, Këshilli Drejtues, si organi më i lartë i Shkollës, të mund të ndryshojë pikët minimale, pa studime të mirëqena, veçanërisht, kur këto ndryshime mund të sjellin pasoja në cilësinë e aplikantëve, si dhe për rrjedhojë, mund të çënojnë besimin dhe imazhin e drejtësisë.

Po ashtu, Shkolla e Magjistraturës, në opinionin tonë, duhet të tregohet më e kujdesshme që, përdorimi apo zgjedhja e termave ligjore, të ndryshme nga ato të përdorura nga legjislacioni në fuqi, të mos ndikojë apo shkaktojë paqartësi, të filla, si ato që pretendohen në rastin e paqartësive që lidhen me kurset e thelluara dhe kurset e posaçme.

**EDHE TI MUND
TË BËHESH MAGJISTRAT!**

BIBLIOGRAFIA

- Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*. <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Relacioni-1.pdf> ;
- Kuvendi i Shqipërisë, *Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar."*. https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20210302110147Projektligji%20per%20statusin%20e%20gjyqtareve%20dhe%20prokuroreve%20ne%20Republiken%20e%20Shqiperise-11-24_compressed.pdf ;
- Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, *Relacion "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës."*;
- Shkolla e Magjistraturës, *Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, datë 29.01.2024;*
- Shkolla e Magjistraturës, *Kthim përgjigje kërkesës për informacion, datë 05.02.2024.*
- Ligj nr. 96/2016, datë 6.10.2016, FZ Nr. 208, datë 7.11.2016;
- Shkolla e Magjistraturës, *Vendim nr. 1, datë 31.01.2017 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës."*;
- Ligj nr. 50/2021, datë 23.3.2021, FZ Nr. 71, datë 14.5.2021;
- Shkolla e Magjistraturës, *Vendim nr. 15, datë 02.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1, datë 31.07.2017 'Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës'";*
- Shkolla e Magjistraturës, *Vendim nr. 3, datë 26.01.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës";*
- Shkolla e Magjistraturës, *Vendim nr. 1, datë 29.01.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës."*

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al